

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këlliçi: Përmes Roni Yeffet, ushtria shqiptare është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze
ADRESA	https://piranjat.al/politike/kellici-permes-roni-yeffet-ushtria-shqiptare-eshte-e-furnizuar-me-tekno-i104272
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:12:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:58:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	22fb52ff478f8d919ab3e9be07db7ec0a6bcd5c07a073277309c9b387f2b239
TEKSTI	45d8b41d08053c65c4590493004e617cbb4d03292af942ae5e7afad6f5e426f8
PAMJA	327f1bcbfffe4f82a8f0848c6d8392742a618ff61d2353cebae428e9a60cf8f5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0a26196a9a0b5d6366d02b0584568bd310d292314a01709dabee9060848ca6b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcd39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0a26196a9a0b5d6366d02b0584568bd310d292314a01709dabee9060848ca6b7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **shqiptare është e furnizuar** ■ **me lehtësira fiskale** ■ **Demokratike** kërkon nga qeveria që të **benet aktori me filmat më** ■ **ekstradimin e Ervin Matës** ■ **me baktere për turistët** ■ **AKU**

[POLITIKE](#)

Këlliçi: Përmes Roni Yeffet, ushtria shqiptare është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 18:58



'Përmes kompanive të kontrolluara nga Roni Efeti, ushtria shqiptare sot furnizohet me pajisje, teknologji dhe lëndë të parë kineze'. Kështu deklaroi ekskluzivisht në 'Task Force' me Sonila Meçon në SYRI TV, nënkryetari i PD, Belind Këlliçi, i cili ngriti akuza të forta ndaj qeverisë Rama për mënyrën se si po furnizohen Forcat e Armatosura shqiptare.

Këlliçi tha se pas këtyre transaksioneve qëndrojnë kompani të lidhura, sipas tij, me biznesmenin Roni Efet dhe se situata përbën një çështje që lidhet drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare.

'Ushtria shqiptare sot është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze dhe gjithashtu me lëndë të parë kineze', deklaroi Këlliçi.

Sipas tij, bëhet fjalë për importe të kryera përmes kompanive të lidhura me Timak Defence, Timak SH.P.K. dhe Guna Tactical, kompani që, sipas pretendimit të tij, kanë rol në furnizimin dhe prodhimin e pajisjeve për strukturat ushtarake shqiptare.

'Ushtria shqiptare sot, dhe unë këtë e them me përgjegjësi të plotë dhe po e jap ekskluzive për emisionin tuaj...

Përmes kompanive të kontrolluara nga Roni Efet, nga Edi Rama si proksi, që është Roni Efeti, sot është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze dhe gjithashtu me lëndë të parë kineze.

Po, që është e ndaluar në mënyrë kategorike për një vend anëtar të NATO-s. Dhe më lejoni t'ju them diçka, se ku ka arritur Edi Rama me Timak-un dhe se ku ka arritur Roni Efeti me mashtrimin. Dhe po themi, Roni Efeti duhet ta kujtojmë dhe një herë, është i njëjti biznesmen që është sot në gjyq në Florida, në Miami, i paditur nga një ish-ortak i tij për vjedhjen e rreth 8 milionë dollarëve duke e mashtruar sikur kishte lidhje, dhe në fakt ai kishte lidhje të tilla, pra ka përdorur Edi Ramën për të ekspozuar lidhjet e tij me Kryeministrin e Shqipërisë dhe duke e mashtruar për ta futur në punë të ndryshme dhe për të marrë asete publike në territorin e Shqipërisë. Por të ndalemi te kjo që ju thashë. Unë dua t'ju lexoj... nuk do ndalemi te gjithë lista e kompanive nga ku importohen baza materiale, teknologjia dhe pajisjet nga Timak Defence, Timak SH.P.K dhe ajo...

Nga Guna Tactical. Por do të ndalemi te dy emra. Emri i parë i kompanisë nga ku importohet sot në mënyrë zyrtare nga Timak Defence, teknologjia dhe pajisjet, quhet Guangzhou Yutong Heavy Machinery Limited China. Është kompani kineze. E dyta, që e di mirë Arjeta Puca se çfarë është kjo kompani, nga ku merret baza materiale për veshjen dhe pajisjet e ushtarëve, e ushtrisë shqiptare...

Quhet Yeni Balkan Makina Otomotiv Ins San Tic Ltd Sti, që është një kompani turke me lidhje familjare drejtpërdrejt me Arjeta Pucën. Por të ndalemi te e para, se kjo përbën interes për publikun e gjerë, për shqiptarët dhe sigurinë kombëtare.

Sot, Republika e Shqipërisë, një vend anëtar i NATO-s, furnizohet me pajisje dhe teknologji nga kompania Guangzhou në Kinë, dhe brenda këtij viti janë importuar, ja po jua them unë, 16 mjete ushtarake dhe po jua lexoj: Kamion i ri, viti 2026, për transport naftë, marka Dongfeng model KLF.

E importuar e sjell në Shqipëri. Kamion i ri, viti 2026, transport naftë, marka Dongfeng model KLF sërish. Auto e re Iveco, këto që u bënë publike dhe u bënë reklamë, Daily Model Van 4x4 viti 2025, 2998 kubik naftë. Ndërkohë Guna, kompania Guna Tactical, importon pëllhurë për veshje 6178 kg. Pëllhurë për veshje 6178 kg. Këto janë transaksione.

Për ushtrinë, për veshjen e të gjithë ushtrisë shqiptare. Dhe këtu janë disa transaksione, pëllhurë për veshje, pëllhurë për veshje, por mbetemi te thelbi. Sot, pajisjet ushtarake, teknologjia importohet nga një kompani kineze në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kjo është e ndaluar, është e sanksionuar. Çdo vend anëtar i NATO-s, është e padiskutueshme që këtë gjë nuk mundet ta bëjë. Dhe sot, edhe ushtarakët, edhe veshjet e ushtarëve, lënda e parë e tyre, nga Guna Tactical importohet nga një kompani kineze.

Tani këtë gjë, këtë gjë mos harroni, nuk ka guxuar ta bëjë deri më sot asnjë vend anëtar i NATO-s, dhe asnjë drejtues, qoftë në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, dhe asnjë zyrtar tjetër.

Dhe që të kuptoni diçka tjetër, para dy muajsh, para dy muajsh t'ju them dhe një gjë tjetër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi dhe huanë prej mbi 300 milionë dollarë e dhënë nga administrata, nga Departamenti Amerikan i Shtetit...

Për, patjetër që u përmend, sepse është në bashkëpunim me administratën amerikane për të rritur jo vetëm financimin, por edhe jo vetëm kuadrin 5% që shpenzimet e prodhimit të brendshëm bruto për sigurinë kombëtare dhe për sektorin ushtarak, por mbi të gjitha për të përmirësuar dhe teknologjinë. Dhe nuk është çudi që këto 300 milionë dollarë Edi Rama t'i marrë dhe t'i çojë te xhepi i Roni Efitit, te xhepi i tij, për të blerë, po e them dhe një herë, pajisje dhe teknologji kineze. Dhe këtë e bën vetëm Edi Rama. Nuk ka politikan të dytë në botë ta bëjë këtë gjë.

Roni Efeti është pronari i Timakut, është 80% pronari i Timakut. Pra që t'ia sqarojmë qytetarëve, kompanitë që kontrollojnë 80% Roni Efeti, në këtë rast është Timak Defence, Timak SHPK-ja, ku Roni është 80% dhe 20% shteti, janë përgjegjëse për importin dhe për prodhimin e pajisjeve ushtarake, teknologjisë, mjeteve të luftës. Sot, lëndën, pajisjet, teknologjinë dhe lëndën e parë e importojnë nga kompani kineze, e marrin nga Kina.', tha deputeti i PD-së, Belind Këlliçi në SYRI TV.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator18:39

[Meta u la në burg, Blushi: Proces farsë me kryeprokuror Ramën](#)

Deputeti i Partisë së Lirisë Tedi Blushi, ka komentuar faktin që GJKKO e ka lënë në burg sot kreun e PL-së Ilir Metë...

POLITIKE 15 Shtator18:37

[“Mbi Ballukun rëndojnë akuzat më të rënda për një zyrtar të lartë”, Bardhi: Pse SPAK i jep kohë Ramës për manovra politike?](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të PD Gazment Bardhi ka vijuar reagimet e tij në kuadër të kërkesës drejtuar SPAK për arrestimin e ...

POLITIKE 15 Shtator18:12

[Qeveria premtos rritje pensionesh në prag të zgjedhjeve vendore](#)

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, në një video të shpërndarë në rrjetet sociale bëri të ditë...

POLITIKE 15 Shtator18:05

[Komisioni i Ligjeve miraton ndryshimet ligjore për pagat e magjistratëve, socialistët përdorin forcën e kartonit](#)

Me 8 vota pro nga socialistët dhe 3 kundër nga demokratët, Komisioni i Ligjeve miratoi ndryshimet ligjore për rritjen e pagave të magji...

POLITIKE 15 Shtator16:51

[Debati te Ligjet/ Ulsi Manja i fik mikrofonin kreut të Unionit të Gjyqtarëve: Jemi ne sovrani](#)

Një debat i tensionuar është zhvilluar sot në Komisionin e Ligjeve mes kryetarit të tij, Ulsi Manja, dhe kreut të Unioni...

POLITIKE 15 Shtator16:41

[Debate për pagat e gjyqtarëve në komisione, Bardhi: S’mund t’i trajtojmë me lëmoshë gjyqtarët](#)

Drafti i paraqitur nga Partia Socialiste për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka hasur me kundërshtimin e opozitës dhe të institut...

POLITIKE 15 Shtator15:40

[Pagat e magjistratëve/ Zv.kryetari i GJL kundër formulës së PS: Nuk e realizon standardin e vendosur nga Kushtetuesja](#)

Zv.kryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda, ka kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve formulën e propozuar për pagat e magjist...

POLITIKE 15 Shtator15:27

[Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon Rama: Askush s’po do t’ia dijë për koston përditë të të parit kryeqytet në botë](#)

Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në fuqi masën e arrestit në...

POLITIKE 15 Shtator15:21

[Bozdo “zbërthen” skemën korruptive: Ron Yeffet erdhi “me duar në xhepa”, qindra miliona euro kalojnë pa asnjë kontroll](#)

Deputeti i Partisë Demokratike, Enno Bozdo ka denoncuar publikisht atë që e quajti një skemë të mirëmenduar korupsioni dhe p...

POLITIKE 15 Shtator15:12

[Strategjia e re amerikane për Ballkanin: Shqipëria përballë sfidës së karteleve dhe krimit të organizuar](#)

Zëvendës Ndihmës Sekretari i Shtetit, Daniel Lawton, do të paraqesë sot përpara Nënkomitetit për Evropën në Ko...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator

[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...](#)


Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimagias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



Çdo të premtë | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.